



Co-funded by the
Erasmus+ Programme
of the European Union



Thirrje për aplikim për mobilitet

Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" hap thirrjen për aplikim për mobilitete, në "Nuertingen-Geislingen University", Gjermani, në kuadër të programit Erasmus+ DualAFS, për semestrin veror 2022/2023 (prej 20 Mars – 7 Korrik, 2023).

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

Shkëmbimin e studentëve për studime Bachelor (1 bursë – 90 ditë) për semestrin veror 2022/2023.

Kandidatit të përzgjedhur për këtë mobilitet, do ti mbulohen shpenzimet e udhëtimit, qëndrimit dhe pagesa e semestrit në Universitetin pritës, sipas udhëzimit të programit Erasmus+ DualAFS.

Të drejtë aplikimi kanë studentët e programeve: Prodhim shtazor dhe Ekonomia e Bujqësisë.

Studentët duhet të akumulojnë së paku 15 ECTS.

Vërejtje: Studentët janë obliguar të përmbushin kërkesat rreth regjistrimit të semestrave në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina".

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Certifikata e notave/Transkripta
- Vërtetimin e studentit që duhet të nxirret në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë dhe që e ka të regjistruar vitin 2022/2023
- CV-në (në gjuhën angleze).
- Kopja e pasaportës (faqja që përmban emrin, foton dhe të dhënat personale)
- Nivel i mirë i gjuhës angleze ose gjermane (të shkruar dhe të folur)
- Letër motivimi në gjuhën angleze (motivi/ide/pritjet – maksimumi 1 faqe A4).

Afati për aplikim është deri më 17 Janar 2023 deri në ora 16:00. Intervistimi i aplikantëve do të bëhet me datë 18 Janar 2022, prej orës 10:00, në objektin e gjelbër.

Dokumentet me titull "Nuertingen-Geislingen University" duhet të dërgohen të skanuara në pdf file, tek: skender.muji@uni-pr.edu.

Vetëm dokumentet e kompletuara do të merren në konsideratë.

Për më shumë informata rreth kurseve që ofrohen, mobilitetit dhe dërgimit të dokumenteve mund të adresoheni në e-mailin alltane.kryeziu@uni-pr.edu.